RAPORT VJETOR 2017

© URDHRI I PSIKOLOGUT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Tabela e lëndës

Përshëndetja e Presidentit **3**
1. Përshkrim i shkurtër i situatës së psikologjisë si disiplinë në Shqipëri **5**
2. Baza ligjore e funksionimit dhe procedurat e ndjekura për ngritjen e Urdhrit **6**
2.1 Asambleja themeluese 6
3. Konstituimi dhe ngritja e institucionit **8**
3.1 Selia e Urdhrit të Psikologut 8
4. Struktura e Urdhrit të Psikologut **8**
4.1 Asambleja Kombëtare 9
4.2 Këshilli Kombëtar 9
4.3 Komisioni i Gjykimit Disiplinor Profesional 10
4.4 Administrata e Urdhrit të Psikologut 11
4.5 Komisione të tjera 11
4.5.1 Komisioni i Licencimit 11
5. Aktiviteti i organeve drejtuese dhe aktet normative të nxjerra gjatë këtij viti **12**
5.1 Këshilli Kombëtar 12
5.2 Asambleja Kombëtare 13
5.3 Komisioni i Etikës dhe Gjykimit Disiplinor Profesional 14
6. Anëtarësia e Urdhrit të Psikologut **14**
7. Ndërtimi i faqes web, regjistrat elektronikë dhe "QR Code" **18**
8. Aktivitetet e Urdhrit **21**
9. Marrëdhëniet kombëtare dhe ndërkombëtare **22**
9.1 Marrëdhëniet Kombëtare 22
9.2 Marrëdhëniet Ndërkombëtare 24
10. Buxheti **25**
11. Objektivat për vitin 2018 **27**

Përshëndetja e Presidentit

(Dr. Valbona Treska - Presidente)

Pas një viti të vrullshëm, të lodhshëm fizikisht dhe psikologjikisht, pas një viti me ëndrra të realizuara dhe me objektiva të qarta për të vijuar më tej, pas një viti me miq, por edhe me jodashamirës, pas një viti me njerëz që besuan në ndërtimin e Urdhrit të Psikologut, por edhe me të tjerë që e panë me dyshim dhe mospërfillje punën tonë, pas një viti me debate, me frikëra, me pasiguri, por edhe me shtrëngime duarsh, kurajo, emocion e dashuri, kam kënaqësinë e madhe të ndaj me Ju punën e realizuar gjatë kësaj periudhe, rezultatet dhe objektivat për të vazhduar përpara. Kam kënaqësinë të ndajmë së bashku rrugëtimin tonë në më pak se një vit kalendarik. Urdhri i Psikologut, institucioni aq shumë i dëshiruar dhe i nevojshëm për të gjithë psikologët profesionistë në Shqipëri, u ngrit në kushtet e një kaosi të plotë të ushtrimit të profesionit të psikologut në vend, çka ka bërë që, padyshim, vendosja e rregullave të jetë një sfidë e vërtetë për të gjithë ne.

***

Institucioni startoi zyrtarisht punën në Shkurt 2017, pas zgjedhjeve të Asamblesë Themeluese të datës 28 Janar 2017, në të cilën u zgjodhën organet e para drejtuese.

Urdhri nisi punën me pajisjen me vulë zyrtare dhe vendosjen e kontakteve institucionale. Krijimi i infrastrukturës, ngritja e selisë, regjistrimi në organet fiskale dhe ndërtimi i një administrate funksionale, ishin disa nga emergjecat e institucionit në dy muajt e parë, të cilat shkuan paralelisht me ngritjen e faqes Web, krijimin e një *database* të rajonalizuar për psikologët, si dhe me përpilimin dhe miratimin në Këshill Kombëtar të akteve normative të domosdoshme për mbarëvajtjen dhe funksionimin e Urdhrit. Në prill 2017, me një infrastrukturë të ngritur në vetëm 2 muaj, nisëm anëtarësimet në Urdhër.

Në qershor 2017 startuam një fushatë sensibilizuese në të gjithë qytetet kryesore të Shqipërisë, për të afruar më shumë psikologët me institucionin e tyre, Urdhrin e Psikologut, si dhe për t'i përgatitur për pjesëmarrjen në të parën Asamble Kombëtare, më 30 qershor 2017. Kjo Asamble miratoi Statutin, Kodin e Etikës dhe Deontologjisë, Rregulloren e Regjistrim-Anëtarësim-Licencimit, Rregulloren e Gjykimit Profesional, si dhe Buxhetin për vitin financiar 2017.

Firmosëm në maj 2017 Memorandumin e Bashkëpunimit me ish-Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, dokument i cili i hapi rrugën licencimit të një kategorie psikologësh, të cilët

sipas ligjit, përjashtoheshin nga provimi i shtetit. Në korrik filloi punën Komisioni i Licencimit, i cili deri në fund të këtij viti ka shqyrtuar me qindra dosje dhe ka aprovuar lejen e ushtrimit të profesionit (licencën) për 307 psikologë.

***

Kemi qenë bashkëorganizatorë në dy konferenca ndërkomëbatare, të organizuara nga Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Instituti i Shëndetit Publik.

Urdhri i Psikologut ka patur një aktivitet të gjerë për të vendosur marrëdhënie ndërkombëtare me institucionet simotra. Në tetor finalizuam një Memorandum Mirëkuptimi me "*COP Spain*", Kolegjin Zyrtar të Psikologëve të Spanjës, dhe në nëntor ishim në cilësinë e të ftuarit special në Konferencën Kombëtare të Psikologëve të Kroacisë, "Croatian Psychological Association".

Grupet e punës, bashkëpunimet ndër-institucionale, evidentimi i problematikave që kërkojnë ndërhyrje në legjislacion për punën e psikologut, kanë qenë pjesë e përditshme e aktivitetit tonë.

***

Urdhri i Psikologut ka patur një vit të vështirë në ngritjen e tij. Ai është rritur së bashku me anëtarësinë dhe me aktivitetet brenda dhe jashtë vendit.

Institucioni, që do të jetë shtëpia e përbashkët e qindra psikologëve në vend e që ende nuk ka festuar 1-vjetorin e tij, është vetëm në hapat e para.

Të gjithë së bashku do të punojmë, që të forcojmë rolin e psikologut në shoqëri, të rrisim cilësinë e shërbimit, të shtojmë numrin e profesionistëve të kualifikuar, të ndërgjegjësojmë qytetarët mbi rëndësinë e profesionistit psikolog të shëndetit, të shkollës, të gjyqësorit e të tjera shërbime me rradhë si dhe t'i hapim rrugën fuqizimit të psikologut organizacional.

Ndihem e nderuar që në këtë rrugëtim të ri të Urdhrit të Psikologut do të jem me Ju dhe pranë Jush. Tek kthej kokën pas dhe shoh me qindra punë të realizuara, ndihem më e motivuar për të ecur përpara dhe me më shumë përgjegjësi. Kam bindjen se ky është vetëm fillimi. Me punën e të gjithëve së bashku, profesioni ynë do të marrë vëmendjen që meriton dhe do të fitojë dinjitetin e munguar gjatë këtyre viteve.

...sepse psikologët profesionistë dinë të afrojnë njerëzit tek njëri-tjetri, të kthejnë vetëbesimin, të rrisin emocionet pozitive e të bëjnë një shoqëri më të mirë.

Faleminderit të gjithëve për mbështetjen Tuaj gjatë këtij viti!

Valbona Treska
Presidente

Tiranë, Shqipëri, Janar 2018

2. Përshkrim i shkurtër i situatës së psikologjisë si disiplinë në Shqipëri

Psikologjia në Shqipëri ka nisur të hedhë hapat e parë në vitet 1980. Në vitin 1996 u hap për herë të parë Departamenti i Psikologjisë pranë Fakultetit të Shkencave Sociale në Tiranë. Pas tij u hapën departamente të psikologjisë edhe në Universitetin e Shkodrës dhe atë të Elbasanit e më pas edhe në një sërë Universitetesh të tjera jo publike.

Që prej vitit 1996 kanë përfunduar studimet në këtë degë me mijra studentë, por, për vite me rradhë, dhe ende as sot, organet shtetërore nuk kanë patur një listë emërore (*database)* të saktë për numrin e të diplomuarve. Mungesa e shifrave të të diplomuarve në tërësi si dhe e specializimit të tyre në profile të caktuara ka sjellë gjatë këtyre viteve mungesën e politikave të qarta për kurrikulat e universiteteve, veçanërisht të programeve master, programeve të punësimit, si dhe mungesën e impaktit për ndryshime ligjore me qëllim implementimin e rolit të psikologut.

Nevoja për punësimin e parë të psikologëve në strukturat shtetërore nisi nga Bashkia e Tiranës në vitin 2002, e cila ngriti sektorin e Shërbimit Social dhe punësoi psikologët e parë që do të ushtronin profesionin e tyre pranë çerdheve të kryeqytetit. Më pas psikologu u shtua në organigramën e shkollave, spitaleve, burgjeve e më vonë edhe pranë rajoneve të policisë, prokurorive dhe institucioneve të tjera më të vogla. Një peshë të madhe të përfshirjes së psikologëve si profesionistë mbajnë gjykatat e nivelit të parë dhe të dytë në të gjithë vendin, si dhe organizatat jo-fitimprurëse.

Rritja e rolit të psikologut pranë gjykatave nisi në vitin 2004 me ndryshimet e reja që iu bënë Kodit të Familjes, veçanërisht në proceset e zgjidhjes së martesave, në të cilat gjykata duhej të shprehej në lidhje me mënyrën e rritjes dhe edukimit të fëmijëve të mitur dhe, që nga ky moment, roli i tyre është zgjeruar edhe në çështje të tjera civile dhe penale. Në kushtet kur nuk ka patur asnjë rregullator të profesionit dhe përfshirja e psikologut në proces ishte dhe vazhdon të jetë vetëm diskrecion i gjyqtarit, në jo pak raste janë përfshirë në proces psikologë që sapo kanë përfunduar studimet e kanë qenë pa përvojë, apo individë, të cilët nuk kanë kryer studimet në psikologji, por kanë marrë përsipër të ushtrojnë profesionin.

Në kushtet e dëshirës dhe nevojës për ushtrimin e profesionit, vitet e fundit ka patur një përpjekje të një grupi të vogël psikologësh për të futur në treg edhe shërbimin psikologjik privat, ndërkohë që psikoterapia është një disiplinë e psikologjisë shumë pak e zhvilluar në Shqipëri.

Gjatë këtyre viteve kanë munguar instrumentat vlerësuese të standardizuara, protokollet e punës, kompetencat e secilit profesionist në disiplina të caktuara të psikologjisë. Trajnimet kanë qenë sporadike, si dhe nuk ka patur asnjëherë një Kod Etike, i cili të vendoste standarde të sjelljes profesionale. Gjithkush ka bërë çka mundur në profesion për të siguruar të ardhura financiare, pa patur një bazë ligjore dhe një rregullator profesional.

Rritja e shpejtë e numrit të psikologëve në treg dhe nevoja për të futur në shina profesionin, solli domosdoshmërinë e krijimit të legjislacionit të posaçëm dhe krijimin e Urdhrit të Psikologut.

3. Baza ligjore e funksionimit dhe procedurat e ndjekura për ngritjen e Urdhrit

Ligji 40/2016 i Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë u miratua nga Kuvendi dhe hyri në fuqi më 24.05.2016. Ministria Mirëqenies Sociale dhe Rinisë u ngarkua nga ligji të zhvillonte zgjedhjet e para për organet drejtuese të Urdhrit dhe të krijonte Institucionin.

Urdhri i Psikologut (në vijim Urdhri) u krijua nga Asambleja Themeluese e datës 28 janar 2017.

Në datën 03 shkurt 2017 Komisioni i Përkohshëm çertifikoi rezultatet e zgjedhjeve dhe i hapi rrugën ndërtimit të institucionit.

Nga Zgjedhjet e para, bazuar në ligj, dolën organet e zgjedhura drejtuese të Urdhrit: Presidenti dhe 11 anëtarë të Këshillit Kombëtar. Sipas ligjit 40/2016 Këshilli Kombëtar përbëhet nga 17 anëtarë, nga të cilët, Presidenti i Urdhrit, 11 anëtarë të zgjedhur dhe 5 anëtarë përfaqësues të ministrive të linjës, që bashkërendojnë punën me Urdhrin, të cilat sipas ligjit janë:

- Ish-Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë - 1 anëtar
- Ministria e Arsimit - 1 anëtar
- Ministria e Drejtësisë – 1 anëtar
- Ministria e Shëndetësisë – 1 anëtar
- Ministria e Mbrojtjes – 1 anëtar.

2.1 ASAMBLEJA THEMELUESE

Në zbatim të detyrimit të përcaktuar në ligj, Ministri përgjegjës për çështjet sociale, me Urdhrin nr. 217, datë 03.10.2016, ngriti Komisionin e Përkohshëm për organizimin e zgjedhjeve të para të organeve drejtuese të Urdhrit të Psikologut. Komisioni i Përkohshëm, i përbërë nga përfaqësues të Fakulteteve të Shkencave Sociale dhe psikologë të tjerë, krijoi një regjistër paraprak të psikologëve, që do të ishin potencialisht anëtarë të Urdhrit të Psikologut në të ardhmen. Ky Komision, në kompetencë të plotë, të dhënë nga dispozitat kalimtare dhe të fundit të Ligjit "Për Urdhrin e Psikologut", përcaktoi një rregullore për zgjedhjet e para për organet drejtuese të Urdhrit të Psikologut dhe regjistroi kandidaturat përkatese për to, ngriti Komisionin e Votimit dhe caktoi datën e zgjedhjeve të para më 28 Janar 2017. Komisioni i Përkohshëm publikoi listën e personave të regjistruar në regjistrin paraprak dhe kandidatët për organet e larta drejtuese: dy kandidatë për vendin e Presidentit; gjashtë kandidatë për tre anëtarë në Këshillin Kombëtar nga radhët e pedagogëve; pesëmbëdhjetë kandidatë për shtatë anëtarë në Këshillin Kombëtar nga radhët e psikologëve që punojnë në institucione, një kandidat për një anëtar nga psikologët që punojnë pranë shoqatave. Çdo

kandidat kishte vëzguesin e vet personal pranë çdo kutie votimi deri në përfundim të numërimit të votave dhe në mbajtjen e procesverbalit përkatës për çdo kuti votimi.

Në votim morën pjesë rreth 400 psikologë që ishin regjistruar paraprakisht në regjistrin paraprak, që u paraqitën ditën e votimit dhe që u identifikuan në bazë të kartës ID nga Komisioni i Votimit. Komisioni i Votimit, për çdo kuti, në mënyrë transparente, duke treguar për vëzhguesit çdo fletë votimi, nxorri rezultatin e votimeve dhe shpalli fituesit.

Ky vendim iu përcoll Komisionit të Përkohshëm, i cili zyrtarisht çertifikoi rezultet e zgjedhjeve. Të gjitha aktet themeluese iu përcollën zyrtarisht nga Minsitria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë organeve të porsangritura të Urdhrit duke i hapur rrugën ngritjes së institucionit.

3. Konstituimi dhe ngritja e institucionit

Menjëherë pas çertifikimit të zgjedhjeve, që në fillim të muajit shkurt 2017, nisi puna për konstituimin e institucionit. Në shkurt 2017 Urdhri u pajis me vulën zyrtare nga Ministria e Mbrojtjes, çka i hapi rrugën zyrtarizimit të marrëdhënieve institucionale. Detyra e parë konsistoi në kërkesën ndaj ministrive të linjës për plotësimin e vendeve me përfaqësues të tyre në Këshillin Kombëtar, në mënyrë që organi të bëhej funksional. Mbledhjet e para jo-formale të Këshillit u realizuan në ambjente private, ndërkohë që nisi puna e ngritjes së selisë së institucionit.

Në ndryshim nga të gjithë ligjet e mëparshme për ngritjen e urdhrave të tjerë profesionalë në vend, në të cilat shteti angazhohej të financonte për një apo dy vite institucionet e sapo krijuara, ligji "Për Urdhrin e Psikologut në RSH" nuk parashikonte asnjë ndihmë financiare për krijimin e tij. Zyrat e Urdhrit dhe e gjithë infrastruktura për funksionim u ngritën mbi bazën e kontributit personal, me qëllim plotësimin e nevojave fillestare imediate për funksionimin e tij.

3.1 Selia e Urdhrit të Psikologut

Si një ent publik, Urdhri i Psikologut duhej të kishte selinë e tij në Tiranë. Për të përmbushur detyrat e aktivitetit të përditshëm të institucionit, si dhe duke marrë në konsideratë të ardhurat financiare, u vlerësua e arsyeshme marrja e ambjenteve me qera në një zonë të aksesueshme nga të gjithë psikologët, me qëllim përmbushjen në mënyrë sa më dinjitoze të shërbimeve ndaj tyre.



Zyrat e Urdhrit u bënë funksionale më 1 mars 2017, ditë në të cilën u realizua edhe mbledhja e parë formale e Këshillit Kombëtar.

Zyrat shtrihen në një ambjent 118 m2, të përbërë nga recepsioni, salla e mbledhjeve, zyra e Presidentit dhe zyra juridiko-financiare.

4. Struktura e Urdhrit të Psikologut

Organet kryesore të Urdhrit janë:
a) Asambleja Kombëtare;
b) Këshilli Kombëtar;
c) Presidenti i Urdhrit;
ç) Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional

Organigrama e Urdhrit të Psikologut



4.1 Asambleja Kombëtare

Organi më i lartë drejtues i Urdhrit të Psikologut, bazuar në ligjin nr.40/2016, është Asambleja Kombëtare. Asambleja Kombëtare përbëhet nga të gjithë anëtarët e Urdhrit të Psikologut.

Asambleja Kombëtare ka këto funksione:

a) zgjedh Këshillin Kombëtar dhe Presidentin e Urdhrit, me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të saj;

b) miraton statutin e Urdhrit;

c) miraton Kodin e Etikës dhe Deontologjisë;

ç) miraton rregulloren për gjykimin disiplinor profesional;

d) miraton rregulloren për regjistrimin, anëtarësimin dhe licencimin;

dh) miraton rregulloren për organizimin e praktikës profesionale;

e) shqyrton dhe miraton projekt-buxhetin e Urdhrit, si dhe shqyrton buxhetin faktik të tij;

ë) analizon veprimtarinë vjetore të organeve të Urdhrit;

f) shqyrton raportin e auditit të jashtëm, në intervale trevjeçare.

4.2 Këshilli Kombëtar

Këshilli Kombëtar i Urdhrit është organi ekzekutiv i Urdhrit, i cili përbëhet nga 17 anëtarë.

Anëtarë të zgjedhur të Këshillit Kombëtar janë:
Dr.Blerta Bodinaku
Prof.As.Arjana Muça (dorëhequr më datën 10.07.2017)
Dr.Brunilda Laboviti
Dr.Valbona Habili
Elona Mustafaraj
Dr.Skerdi Zahaj
Gracela Mana
Sonila Meçaj
Denada Toçe
Redina Balla
Rezarta Basha

Në përbërjë të Këshillit Kombëtar janë edhe 5 anëtarë të caktuar nga Ministritë, aktualisht vetëm 4 anëtarë[1], përkatësisht nga:

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (njëkohësisht edhe Autoriteti Kompetent i Urdhrit të Psikologut sipas ligjit)
2. Minitria e Arsimit Sportit dhe Rinisë
3. Ministria e Drejtësisë
4. Ministria e Mbrojtjes

[1]Në bazë të ligjit 40/2016 ishin 5 anëtarë të caktuar nga Ministritë e linjës, si pjesë e Këshillit Kombëtar, duke përfshirë këtu edhe ish-Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Kjo ministri, me vendim të Qeverisë së Shqipërisë u shpërbë në shtator 2017. Të gjitha kompetencat e saj i kaluan Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Kjo bëri që numri i antërave të caktuar në Këshillin Kombëtar prej shtatorit 2017 të reduktohej në katër.

Këshilli Kombëtar ka këto përgjegjësi:

a) miraton strukturën e vet organizative;

b) cakton kuotizacionin dhe tarifat;

c) administron pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të Urdhrit në nivel kombëtar;

ç) mbikëqyr të gjithë veprimtarinë e organeve që varen prej tij;

d) harton statutin, rregulloret e Urdhrit, si dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë dhe ia propozon ato për miratim Asamblesë Kombëtare;

dh) mban dhe përditëson Regjistrin e Urdhrit të Psikologut;

e) ngre grupe pune *ad hoc* për kryerjen e kontrolleve për ushtrimin e profesionit të psikologut;

ë) përgatit dhe publikon raportin vjetor dhe financiar.

4.3 Komisioni i Gjykimit Disiplinor Profesional.

Ky komision ngrihet pranë Urdhrit në zbatim të nenit 19 të Ligjit 40/2016 "Për Urdhrin e Psikologut". Bazuar në këtë nen, Këshilli Kombëtar me vendim nr. 20, dt. 13.10.2017, ngriti Komisionin e Gjykimit Disiplinor Profesional. Ky komision, bazuar në Rregulloren e Gjykimit Disiplinor Profesional, miratuar me nr. 16 , datë 18.05.2017, me vendim të Këshillit Kombëtar, ka një mandat 3 vjeçar. Mandati 3 vjeçar u përcaktua me qëllim ruajtjen e integritetit të strukturave dhe të vazhdimësisë së funksionimit të tyre. Mandati 3 vjeçar u caktua gjithashtu që funksionimi i tij të mos përkonte me mandatin 4 vjeçar të përcaktuar në ligj për Presidentin dhe Këshillin Kombëtar dhe organet të ruanin pavarësinë nga njëri-tjetri.

Komisioni i Gjykimit Disiplinor ka në strukturën e tij 5 anëtarë me një eksperiencë pune mbi 10-vjeçare në profesion.

- Dr.Edvin Lame
- Dr.Jonida Haxhiu
- Dr.Migena Buka
- Dr.Stela Dhima
- Dr.Prof.Anjeza Vila

Komisioni funksionon në bazë të Ligjit për Urdhrin e Psikologut, Kodit të Etikës dhe Deontologjisë, si dhe Rregullores së Gjykimit disiplinor profesional.

4.4 Administrata e Urdhrit të Psikologut

Duke pasur parasysh mungesën e mbështetjes financiare për ngritjen dhe funksionimin e Urdhrit, si dhe vështirësitë në mbledhjen e të ardhurave financiare nga anëtarësia gjatë këtij viti të parë, u vlerësua e arsyeshme krijimi i një administrate minimale, e cila do të mund të kryente veprimtarinë e përditshme.

Administrata përbëhet nga:

- Zyra Juridike – një punonjës, Z.Igli Çutra
- Zyra e Financës – një punonjës, Z.Lejdi Goga
- Sekretariati, protokolli, arshiva – një punonjëse, Zj.Armira Baboçi

Për nevoja të ngritjes së infrastrukturës ligjore dhe asistencës së specializuar juridike, që ka qënë një domosdoshmëri në këtë vit të parë, Urdhri i Psikologut ka nënshkruar me zyrën e konsulencës ligjore "*BHF Consulting*" një marrëveshje për dhënien pa pagesë të asistencës juridike për një periudhë 1 vjeçare. (Marrëveshje Konsulence Nr.15 Prot., datën 08.04.2017).

4.5 Komisione të tjera

Pranë Urdhrit të Psikologut funksionojnë komisione të tjera, të cilat janë të domosdoshme për realizimin e misionit të tij.

4.5.1 Komisioni i Licencimit

I ngritur me vendim nr. 13 dt. 29.03.2017 nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut, i ndryshuar me vendim nr.17 dt. 16.06.2017, (po nga ky Këshill), Komisioni i Licencimit ka në strukturën e tij 5 anëtarë, nga të cilët:

- 3 anëtarë nga Këshilli Kombëtar:
  Dr.Skerdi Zahaj
  Sonila Meçaj
  Gracela Mana
- 1 anëtar nga zyra juridike e Urdhrit të Psikologut - Z.Igli Çutra
- Presidenti - Dr.Valbona Treska

Komisioni i Licencimit ka nisur punën e tij në 12 Korrik 2017. Ai ka realizuar 7 (shtatë) mbledhje dhe ka shqyrtuar dhe rishqyrtuar 405 dosje lidhur me kërkesat e anëtarëve për licencim.

5. Aktiviteti i organeve drejtuese dhe aktet normative të nxjerra gjatë këtij viti

5.1 Këshilli Kombëtar

Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut të Republikës së Shqipërisë, përgjatë këtij viti, ka patur një aktivitet shumë të ngjeshur, veçanërisht gjatë tremujorit të parë të ngritjes së institucionit. Duke marrë në konsideratë se për një kohë të shkurtër institucioni duhej të bëhej funksional, lindi nevoja e përpilimit dhe miratimit të një numri të konsiderueshëm aktesh normative, një pjesë e të cilave, pas shqyrtimit dhe miratimit në Këshillin Kombëtar, i kaluan për miratim Asamblesë Kombëtare, organit më të lartë të Urdhrit të Psikologut.

Në një periudhë kohore të shtrirë nga marsi deri në tetor 2017, Këshilli ka zhvilluar 7 mbledhje zyrtare, në të cilat janë marrë këto vendime:

- Vendim Nr. 1, dt. 01.03.2017 "Për marrjen në dorëzim të akteve themeluese të Urdhrit të Psikologut"
- Vendim Nr. 2, dt. 01.03.2017 " Përcaktimi i tarifës së kuotizacionit"
- Vendim Nr. 3, dt. 01.03.2017 "Përcaktimi i procedurave për hartimin e Rregullores Administrative"
- Vendim Nr. 4, dt.01.03.2017 "Për hartimin e Rregullores për Administrimin dhe Përditësimin e Regjistrit Themeltar të Urdhrit të Psikologut"
- Vendim Nr. 5, dt. 01.03.2017 "Për hartimin e Rregullores Financiare"
- Vendim Nr. 6, dt. 01.03.2017 "Për hartimin e Projekt-Buxhetit"
- Vendim Nr. 7, dt. 01.03.2017 "Për hartimin e Statutit të Urdhrit të Psikologut"
- Vendim Nr. 8, dt. 23.03.2017 "Miratimi i Statutit dhe Rregullores Administrative"
- Vendim Nr. 9, dt. 23.03.2017 "Miratimi i Rregullores Financiare".
- Vendim Nr. 10, dt. 23.03.2017 "Miratimi i Rregullores Për Regjistrimin, Anëtarësimin dhe Licencimin në Urdhrin e Psikologut".
- Vendim Nr. 11, dt. 29.03.2017 "Miratimi i Projekt-Buxhetit".
- Vendim Nr. 12, dt. 29.03.2017 "Përcaktimi i honorareve të Anëtarëve të Këshillit Kombëtar".
- Vendim Nr. 13, dt. 29.03.2017 "Ngritja e Komisionit të Licencimit".
- Vendim Nr. 14, dt. 29.03.2017 "Përcaktimi i procedurës për hartimin e Kodit Etik dhe Deontologjik të Urdhrit të Psikologut".
- Vendim Nr. 15, dt. 18.05.2017 "Miratimi i Kodit Etik dhe Deontologjik të të Urdhrit të Psikologut".
- Vendim Nr. 16, dt. 18.05.2017 "Miratim i Rregullores së Gjykimit Disiplinor Profesional"
- Vendim Nr. 17, dt. 16.06.2017 "Zgjerim i Komisionit të Licencimit".
- Vendim Nr. 18, dt.16.06.201 "Për përcaktimin e kritereve për licencimin e psikologëve që kanë ushtruar profesionin përpara hyrjes në fuqi të ligjit".
- Vendim Nr. 19, dt. 16.06.2017 "Përcaktimi i Tarifës së Licencimit".
- Vendim Nr. 20, dt. 13.10.2017 "Ngritja e Komisionit Etik të Gjykimit Disiplinor Profesional"
- Vendim Nr. 21, dt. 13.10.2017 "Përcaktimi i honorareve për anëtarët e Komisionit të Etikës dhe të Gjykimit Disiplinor Profesional dhe për anëtarët e Komisionit të Licencimit".

5.2 Asambleja Kombëtare

Këtë vit, më datë 30.06.2017, u mbajt Asambleja e Parë e Përgjithshme e Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë. Asambleja miratoi të gjitha Aktet Themeltare të Urdhrit të Psikologut si më poshtë:

Statuti i Urdhrit të Psikologut të Shqipërisë

Statuti i Urdhrit të Psikologut shërben për përcaktimin e bazës ligjore dhe është akti themelor mbi të cilin funksionon institucioni i Urdhrit të Psikologut. Urdhri i Psikologut është krijuar në bazë të Ligjit Nr.40/2016 "Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë" dhe është ent publik jobuxhetor, profesional, i pavarur, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkëta të anëtarëve të Urdhrit dhe rregullon veprimtaritë e marrëdhëniet midis tyre në funksion të publikut.

Rregullorja për Regjistrimin, Anëtarësimin dhe Licencimin në Urdhrin e Psikologut.

Rregullorja për Regjistrimin, Anëtarësimin dhe Licencimin në Urdhrin e Psikologut, ka për qëllim vendosjen e kritereve dhe normave për regjistrimin, anëtarësimin dhe pajisjen me Licencë për ushtrimin individual të profesionit të Psikologut.

Kodi i Etikës dhe Deontologjisë.

Kodi Etik e Deontologjik ka si qëllim të përcaktojë standarde të sjelljes profesionale dhe të zbatohet në cdo aspekt të ushtrimit të profesionit nga psikologu.
Kodi Etik e Deontologjik përbëhet nga:

a) Hyrja; e cila përshkruan qëllimin, organizimin, dhe fushën e zbatimit të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë,

b) Parathënia dhe 5 Parimet e Përgjithshme; të cilat kanë si qëllim që të udhëheqin psikologët drejt idealeve më të larta në fushën e psikologjisë,

c) Standardet etike; të cilat përcaktojnë rregullat e duhura të sjelljes për psikologun.

Rregullorja e Gjykimit Disiplinor

Rregullorja e Gjykimit Disiplinor Profesional ka si qëllim të vendosë parimet dhe rregullat bazë, për të siguruar një gjykim disiplinor objektiv, të drejtë dhe të paanshëm, të mbrojë anëtarin e Urdhrit nga një ndëshkim arbitrar dhe i pa merituar, si dhe të evidentojë e ndëshkojë shkeljet profesionale, nëpërmjet gjykimit disiplinor bazuar në ankesat e mbërritura në Urdhër.

Buxheti

Buxheti disiplinon të gjitha shpenzimet, që do të kryhen përgjatë vitit kalendarik 2017, të grupuara sipas zërave.

Të gjitha vendimet e marra nga Këshilli Kombëtar dhe Asmableja Kombëtare janë të aksesueshme në faqen web: http://www.urdhriipsikologut.al/vendime/

5.3 Komisioni i Etikës dhe Gjykimit Disiplinor Profesional

Komisioni i Gjykimit Disiplinor Profesional nisi punën në 27 tetor 2017. Ankesat e para të depozituara dhe protokolluara në Urdhrin e Psikologut datojnë që në muajin mars, kohë në të cilën nisi funksionimi i institucionit.

Lindur nga nevoja e të paturit të një model-tip për ankesën e individit apo institucioneve ndaj një psikologu të caktuar, u hartua "Formulari i Ankesës", i cili është lehtësisht i aksesueshëm në faqen tonë të web-it: http://www.urdhriipsikologut.al/formular-ankese/

Komisioni gjykon në bazë të "Ligjit 40/2016 për Urdhrin e Psikologut", "Statutit", "Kodit të Etikës dhe Deontologjisë" dhe "Rregullores së Gjykimit Disiplinor Profesional".

Gjatë kësaj periudhe 2 mujore, duke u bazuar edhe në respektimin e afateve dhe procedurave të caktuara në aktet normative, Komisioni ka shqyruar në bazë të ankesës së qytetarëve 4 (katër) çështje kundrejt psikologëve, ndaj të cilëve është drejtuar ankesa. Njëra prej ankesave është iniciuar *ex officio* nga Presidenti, nisur nga denoncimi i një rasti në një prej emisioneve investigative në një televizion publik.

6. Anëtarësia e Urdhrit të Psikologut

Për të qenë anëtar i Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë, psikologët duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

- të kenë diplomën e studimeve të larta "Bachelor" dhe "Master shkencor" ose "Master profesional" në psikologji ose ekuivalent me të, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë, brenda

apo jashtë vendit, të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin;

- të mos jenë të dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që lidhet me ushtrimin e profesionit, në momentin e kërkesës për anëtarësim.

Në mënyrë përjashtimore, personat, të cilët në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ushtrojnë profesionin e psikologut dhe kanë përfunduar dy cikle studimi në psikologji, (të ndryshme nga Bachelor dhe Master), dhe që kanë përvojë 5-vjeçare, pa ndërprerje nga puna, në ushtrimin e profesionit të psikologut, regjistrohen në Urdhrin e Psikologut.

Anëtarësia ka patur një rritje të shpejtë gjatë muajve që nga prilli deri në dhjetor 2017. Administrata e Urdhrit në vazhdimësi ka bërë një punë të madhe sensibilizuese jo vetëm karshi vetë psikologëve, por edhe në institucionet publike e private, të cilat janë ndërgjegjësuar për nevojën e zbatimit të ligjit dhe janë mbajtur të informuar në vijimësi me fazat e zhvillimit të institucionit.

Në total numri i psikologut ka arritur deri më sot 655 anëtarë të regjistruar.

REGJISTRIMET E ANËTARËSISË SIPAS MUAJVE



	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	Shtator	tetor	nëntor	dhjetor	Totali vjetor
Anëtarë të rregjistruar	-	151	107	151	35	16	66	41	79	9	655

Psikologë të licencuar

Licencimi i psikologëve rregullohet në bazë të Ligjit "Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë". Sipas këtij ligji, pas përmbylljes së studimeve Bachelor dhe Master në psikologji, duhet të kryhet praktika një- vjeçare profesionale dhe më pas të jepet provimi i shtetit,

si parakusht për licencimin. Përjashtimisht, në këtë ligj parashikohet se psikologët, të cilët e kanë ushtruar profesionin përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përjashtohen nga detyrimi për të dhënë provimin e shtetit. Në këto kushte, në përmbushje të detyrimeve ligjore[2], Urdhri inicioi procesin e licencimit për këtë kategori të psikologëve, bazuar në Ligjin Nr.10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në R.Sh" (i ndyshuar)[3] dhe Memorandumin e Bashkëpunimit mes ish-Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe Urdhrit të Psikologut[4].



Këshilli Kombëtar, me vendim të posaçëm, përcaktoi kriteret për licencimin për të gjithë ata anëtarë, që kishin ushtruar në mënyrë të rregullt profesionin përpara hyrjes në fuqi të ligjit dhe që

[2] Neni 6 i Ligjit Nr. 40/2016 "Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë", pika 1: Misioni i Urdhrit të Psikologut është nxitja dhe ruajtja e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesionit në fushën e psikologjisë, si dhe mbrojtja e përfituesve të shërbimit nga kequshtrimi i profesionit të psikologut. Po aty, pika 2.: Për realizimin e misionit të tij, Urdhri i Psikologut ushtron këto kompetenca: a) jep dhe heq të drejtën për ushtrimin e profesionit të psikologut;

[3] Neni 9 i Ligjit Nr.10 171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë" (i ndyshuar), pika 4.: Përjashtohet nga detyrimi për të dhënë provimin e shtetit: a) profesionisti që, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ushtron ose ka ushtruar një profesion të rregulluar;

[4] Memorandum Bashkëpunimi mes MMSR dhe UP, me nr. 2980 prot. të MMSR dhe nr. 22 prot. të UP, datë 19.05.2017, neni 3: MMSR, përmes strukturave të saj, merr përsipër kryerjen e detyrave të mëposhtme: b) të mbështesë dhe inkurajojë Urdhrin e Psikologut në nisjen e procesit të licensimit të psikologëve, që kanë ushtruar profesionin përpara hyrjes në fuqi të ligjit 40/2016 "Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë". Po aty, neni 4: Urdhri i Psikolout në Republikën e Shqipërisë merr përsipër kryerjen e detyrave të mëposhtme: a) Të nisë procedurat për licensimin e psikologëve që kanë ushtruar profesionin përpara hyrjes në fuqi të ligjit 40/2016 "Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë", duke informuar MMSR për të gjithë hapat e ndërmarra.

përjashtoheshin nga detyrimi për dhënien e provimit të shtetit.

Komisioni i Licencimit ka miratuar deri tani 307 Leje Individuale për Ushtrimin e Profesionit të Psikologut (Licencë Profesionale).

Psikologë të Licencuar	Datë[5] 01.09.2017	Datë 22.11.2017	Total
Total të Licencuar	154	153	307
Psikologë Klinikë	74	73	147
Psikologë Shkollorë & Organizacionalë	26	22	48
Psikologë Shkollorë	10	18	28
Psikologë Organizacionalë	4	4	8
Psikologë në Institucione	8	9	17
Psikologë në Këshillim Psikologjik	23	18	41
Psikologë në Kërkim Psikologjik	-	5	5
Psikologë në Orientim Profesional	4	5	9
Psikologë Ligjorë	5	-	5
Psikologë të Përgjithshëm	4	4	8
Psikologë Komuniteti	1	1	2
Psikologë në Rehabilitim Psikologjik	1	-	1

7. NDËRTIMI I FAQES WEB, REGJISTRAT ELEKTRONIKË DHE *"QR CODE"*

Në mars 2017 u bë funksionale dhe u publikua faqja zyrtare elektronike e Urdhrit të Psikologut: www.urdhriipsikologut.al

Faqja është e ndarë në disa seksione, ndër të cilat: organet e Urdhrit të Psikologut, legjislacioni, aktivitete, vendime, etj. Në faqe publikohet gjithashtu çdo njoftim i rëndësishëm, për të cilin psikologët duhet të informohen në kohë reale.

[5] Grupi i parë i të licencuarve mban datën 01.09.2017 dhe grupi i dytë 22.11.2017

Ndër seksionet më të rëndësishme të faqes web janë dy regjistrat elektronikë të publikuar:

Regjistri i anëtarësisë dhe Regjistri i psikologëve të licencuar.

Regjistri i anëtarësisë

Ky regjistër përmban listën e psikologëve të anëtarësuar në Urdhër. Aty gjenden të dhënat identifikuese për secilin psikolog. Regjistri është ndërtuar të funksionojë në dy sisteme. Në sistemin elektronik përfshihet çdo e dhënë për psikologët anëtarë, ndërkohë që në regjistrin *online* publikohen dhe janë të dukshme vetëm të dhëna të domosdoshme për psikologët.

Regjistri *online* i publikuar është i ndarë në këto rubrika: numri identifikues për çdo të anëtarësuar, emri/mbiemri, vendbanimi dhe numri i kontaktit ose në mungesë adresa e postës elektronike. Vendbanimi është një e dhënë e domosdoshme në mënyrë që të interesuarit të identifikojnë psikologët që ushtrojnë profesionin pranë vendbanimeve të tyre për të marrë shërbim më të shpejtë kur u nevojitet.

Numri i telefonit u vlerësua të shtohej në regjistër, si një mënyrë efikase për kontaktimin e psikologut. Kjo pasi, jo të gjithë të interesuarit kanë akses në postën elektronike, ndërkohë që mungojnë adresat e sakta të vendit në të cilin psikologu ushtron profesionin. Në kuadër të zbatimit të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, psikologët, që kanë dakordësuar për publikimin e numrit të telefonit, kanë nënshkruar një deklaratë për lejimin e publikimit të kësaj të dhëne.

Regjistri i psikologëve të licencuar

Regjistri i psikologëve të licencuar është publikuar në shtator 2017 dhe është ende në ndërtim për plotësimin e mëtejshëm të të dhënave të domosdoshme të secilit psikolog.

Ky regjistër përmban aktualisht këto rubrika; numrin e licencës, titullin, vendbanimin, dhe foton.

Të dy regjistrat përditësohen në bazë të anëtarësimeve dhe licencimeve të reja.

Kodi QR

Një risi, që u përdor për herë të parë nga urdhrat profesionalë në Shqipëri, ishte përdorimi i Kodit QR si element identifikues dhe sigurie për çdo psikolog si në kartën e anëtarësisë ashtu edhe lejen individuale të ushtrimit të profesionit.

Çdo leje e ushtrimit të profesionit dhe karta vjetore e anëtarësisë e përmbajnë këtë element sigurie, i cili nëse lexohet me një aplikacion të zakonshëm lidhet drejtpërdrejt me regjistrin e psikologëve të licencuar *online* dhe gjeneron të dhënat personale të psikologut përkatës.

Ky element sigurie shërben për ruajtjen e personalizuar të të dhënave personale, rritjen e transparencës dhe sigurisë, si dhe për të bërë të mundur ofrimin e shërbimeve të personalizuara.

8. AKTIVITETET E URDHRIT

Edhe pse nje institucion i ri, Urdhri i Psikologut është angazhuar këtë vit në një sërë aktivitetesh, si organizator dhe bashkëorganizator.

➢ 25 maj 2017 kemi qene pjesë e Panairit të Punës të organizuar nga Universiteti Europian i Tiranës. Pjesëmarrja në këtë panair ishte në kuadër të informimit për rolin, misionin dhe rëndësinë e Urdhrit të Psikologut.

➢ Menjëherë mbas hartimit të akteve funksionale të Urdhrit të Psikologut dhe miratimit paraprak të tyre nga Këshilli Kombëtar, u ndërmor një fushatë sensibilizuese nëpër rajone të ndryshme të vendit, me qëllim njohjen e tyre, për shkak të rëndësinë që ato kanë në punën e çdo psikologu.

Fushata është zhvilluar në rrethet:

- Korçë, në datë 03.06.2017

- Elbasan, në datë 05.06.2017



- Lezhë, në datë 06.06.2017

- Vlorë, në datë 07.06.2017
- Durrës, në datë 14.06.2017

- Fier, në datë 21.06.2017

➢ Urdhri i Psikologut ka zhvilluar gjatë këtij viti leksion të hapur me Prof.Ray Bull dhe Bianca Baker, datë 28 shtator 2017. Aktiviteti u zhvillua në bashkëpunim me FSHS dhe Albanian University. Temat e leksionit të hapur në Fakultetin e Shkencave Sociale ishin:

Prof.Ray Bull: "*What makes accounts for interviews credibile*"

Bianca Baker: "*Your Future in Forensic and Legal Psychology*"

Gjatë këtij aktiviteti u bë edhe shpërndarja e licencave të para, një moment i veçantë dhe i shumëpritur nga të gjithë psikologët në vend.

Temat e leksionit të hapur në "Albanian University":

Prof.Ray Bull: "*Psychological research of the interviewing of suspects*".

➢ Bashkëorganizator me FSHS për realizimin e Konferencës Ndërkombëtare "*Psycho-social dynamics of development and education challenges*", zhvilluar në datat 24-25 Nëntor.

➢ Open Day, në datë 22.12.2017, ditë në të cilën u bë edhe shpërndarja e licencave të grupit të dytë të të licencuarve.

9. MARRËDHËNIET KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE

9.1 Marrëdhëniet Kombëtare

Që në hapat e para të tij, Urdhri pati prioritet krijimin dhe fuqizimin e marrëdhënieve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Marrëdhëniet institucionale, veçanërisht me ministritë e linjës, por edhe me institucionet e varësisë së tyre, si dhe ato të pushtetit lokal, kanë ndihmuar ngritjen dhe zhvillimin tonë.

➢ Autoriteti kompetent, ish-Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, ka luajtur një rol vendimtar që në ndërtimin e Urdhrit dhe më pas në miratimin e akteve normative të nevojshme. Memorandumi i Bashkëpunimit, i nënshkruar më datë 19 Maj 2017, mes dy institucioneve tona, i hapi rrugën procesit të licencimit të psikologëve, të cilët kishin përfunduar studimet përpara hyrjes në fuqi të ligjit.

➢ Në shtator 2017, me ndryshimet në strukturën e qeverisjes kombëtare, përgjegjësia si autoritet kompetent për Urdhrin e Psikologut i kaloi Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale. Bashkëpunimi i ngushtë solli që në një kohë të shpejtë të hartohej draft Rregullorja e Praktikës Profesionale, e cila pritet të hyjë në fuqi në fillim të vitit 2018, pasi të nënshkruhet sipas ligjit nga autoriteti kompetent dhe Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë.

➢ Urdhri ka patur gjithashtu bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, ministria që mbulon numrin më të madh të psikologëve të punësuar në administratë. Janë realizuar disa takime punë gjatë këtij viti, janë diskutuar propozime dhe po punohet për nxjerrjen e një Udhëzimi lidhur me shërbimin psiko-social në shkolla.

➢ Janë vendosur kontaktet me Ministrinë e Drejtësisë. Në takimet e realizuara theksi është vënë në fuqizimin dhe rregullimin e rolit të psikologut pranë gjykatave. Me ndryshimet e reja të Kodit Civil dhe hyrjes së tij në fuqi më 4 Nëntor 2017, doli e nevojshme hartimi i projekt-drafteve për propozime lidhur me psikologun në drejtësi, të cilat do të zyrtarizohen nga aktetet nënligjore që janë në proces. Janë vendosur marrëdhëniet e bashkëpunimit për mënyrën e rregullimit të rolit të psikologut në implementimin e "Kodit penal për të mitur", i cili hyn në fuqi në janar 2018.

Bashkëpunim të ngushtë ka patur me Ministrinë e Drejtësisë lidhur me funksionimin e psikologëve të cilët thirren në cilësinë e ekspertit në gjykatë. Prej disa muajsh tashmë, gjykatat e të dy niveleve në të gjithë vendin kanë nisur të ndërgjegjësohen për të mos përfshirë në proceset gjyqësore psikologë të palicencuar.

Ndërgjegjësimi dhe sensibilizimi i gjyqësorit, vlerësojmë të ketë qenë një ndër punët me të frytshme të Urdhrit, gjatë këtij viti.

➢ Urdhri i Psikologut ka vendosur kontakte dhe ka patur një bashkëpunim të vazhdueshëm dhe efikas me zyrën e Koordinatorit Kombëtar për Çështjet e Ekstremizmit të Dhunshëm, pranë Kryeministrisë.

Po bashkëpunojmë për fushatat sensibilizuese të ndërmarra në të gjithë Shqipërinë në bashkëpunimin me Ministrinë e Arsimit dhe organizata ndërkombëtare që operojnë në vend për leximin e shenjave të hershme të sjelljeve anti-shoqërore, radikale dhe ekstremiste në ambientet e shkollave.

9.2 Marrëdhëniet Ndërkombëtare

Vendosja e kontakteve, zyrtarizimi i marrëdhënieve dhe bashkëpunimi me shoqatat e psikologëve, Urdhrat dhe oragnizatat e rëndësishme në Europë, SHBA, e më gjërë, ka qenë në fokusin e punës sonë, që në muajin e parë të ngritjes së institucionit.

Korrespondencat e vazhdueshme, dëshira dhe vullneti për të marrë nga eksperiencat e shoqatave të rëndësishme të psikologjisë, që kanë fuqizuar dhe stabilizuar rolin e psikologut në dekadat e fundit, janë finalizuar gjatë këtij viti me disa bashkëpunime shumë të rëndësishme.

➢ Në tetor 2017 një delegacion i Urdhrit të Psikologut të Shqipërisë, kryesuar nga Presidenti, realizoi një vizitë pune në Spanjë me *"Consejo General de la Psicologia de Espana"*. Memorandumi i Mirëkuptimit i nënshkruar nga Presidente Dr.Valbona Treska dhe Presidenti Francisco Santolaya PhD, i hapi rrugën bashkëpunimit ndërinstitucional.

Marrëdhënia e vazhdueshme me COP Spanjë ka qenë një ndihmesë e madhe në draftet që po

punohen aktualisht për protokollet e punës së psikologëve.

➢ Në nëntor 2017, Urdhri i Psikologut, në një delegacion të kryesuar nga Presidente Znj.Treska, mori pjesë në Konferencën e 25 Kombëtare të Psikologëve Kroatë, organizuar në Zadar, Kroaci, në cilësinë e të ftuarit special.

Pjesëmarrja në këtë aktivitet zyrtarizoi marrëdhënien mes palëve. Presidenti i psikologëve kroatë, Josip Lopizic, ka qenë që në fillim një nga promovuesit e Urdhrit të Psikologëve të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare dhe veçanërisht në procesin e anëtarësimit në EFPA.

➢ Urdhri i Psikologut ka patur gjithashtu korrespondencë shkresore dhe elektronike me Urdhrin e Psikologëve të Portugalisë "*Ordem dos Psicólogos Portugueses"*, me të cilët pritet të zyrtarizojë marrëdhënien e bashkëpunimit gjatë një vizite pune në Shkurt 2018.

➢ Në cilësinë e organit më të lartë të psikologëve të Shqipërisë, kemi vendosur gjithashtu marrëdhëniet me shoqata të tjera simotra në Europë, me të cilat pritet bashkëpunim i frytshëm gjatë vitit në vazhdim, si dhe jemi ftuar në disa konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe samite në fushën e psikologjisë, të cilat pritet të mbahen gjatë vitit 2018 në Europë e SHBA.

➢ Në korrespondencë të vazhdueshme me përfaqësues të Shoqatës Europiane të Psikologëve të Punës dhe Organizacionalë *"European Association of Work and Organizational Psychology ("EAWOP")* dhe me mbështetjen e plotë prej tyre, me qëllimin për tu anëtarësuar me të drejta të plota, përfunduam në tetor 2017 aplikimin për anëtarësim në EAWOP. Në maj 2018, një delegacion i Urdhrit është ftuar në cilësinë e anëtarit në pritje, në takimin e Anëtarëve të EAWOP që do të mbahet në Torino, Itali. Anëtarësimi në Shoqatën Europianë të Psikologëve të Punës dhe Organizacionalë do të jetë një hap shumë i rëndësishëm në fuqizimin e rolit të psikologut organizacional në Shqipëri. Në bashkëpunim me EAWOP synojmë të realizojmë ndryshime në legjislacionin shqiptar për një përfshirje të gjerë të psikologut organizacional në institucione dhe ndërrmarrje publike dhe private në vend.

➢ Prioritet i Urdhrit të Psikologut, që në fillimet e tij, ka qenë angazhimi për anëtarësim në Federatën Europiane të Shoqatave të Psikologëve, "*European Federation of Psychologists' Associations* (EFPA)". Bashkëpunimet e ngushta me COP të Spanjës dhe HPD Kroaci, kanë ndihmuar definitivisht në përshpejtimin e hapave për anëtarësim.

➢ Aktualisht kemi vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me Departamentin e të drejtave të njeriut të EFPA, (*Human Rights*) dhe synojmë të konkretizojmë bashkëpunimin në projekte të përbashkëta.

`

10. BUXHETI

Buxheti i vitit 2017 synonte të garantonte konsolidimin e institucionit dhe të ndihmonte në përmbushjen e misionit të tij. Një nga objektivat strategjikë të Udhrit ishte përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të përbashkëta të anëtarëve të Urdhrit, duke rregulluar veprimtarinë profesionale të tyre në funksion të publikut. Nisur nga sa më lart, është konsideruar që në këtë vit të parë të funksionimit të realizohej:

- ngritja e Urdhrit si institucion i qëndrueshëm, me një seli funksionale dhe që përmbushte nevojat minimale të funksionimit të tij;
- ngritja e infrastrukturës fizike, administrative dhe profesionale;

Të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2017 sipas zërave	
Kuotizacioni vjetor	**3,972,000 ALL ose rreth 29,865 EUR**
Tarifa e regjistrimit	**1,448,000 ALL ose rreth 10,887 EUR**
Tarifa e licencimit	**3,525,000 ALL ose rreth 26,504 EUR**
TOTAL	**8,945,000 ALL ose rreth 67,256 EUR**

- ngritja e infrastrukturës ligjore dhe nënligjore, mbi bazën e së cilës do të funksiononte ky institucion në vijimësi;
- kryerja e funksionit bazë në lidhje me anëtarësimet dhe licencimet e anëtarëve të tij, etj.



Vështirësia më e madhe gjatë këtij viti të parë ka qenë ngritja e institucionit pa asnjë ndihmë financiare. Që në 3 shkurt e deri më 4 prill 2017, kur nisën kuotizacionet e para dhe institucioni u regjistrua në organet tatimore, shpenzimet janë mbuluar me kontribut individual.

Fillimisht, mbledhja e koutizacioneve, deri në periudhën gusht-shtator 2017, ka qenë në nivele të ulëta dhe Urdhri i Psikologut ka përballuar me shumë vështirësi nevojat e përditshme institucionale. Shumë shpenzime kanë vijuar të realizohen me kontribute individuale gjatë këtyre muajve. Me të ardhurat e mbledhura deri në fund të muajit korrik, Urdhri rrezikonte të mos plotësonte deri në fund të vitit detyrimet për paga dhe qeramarrje.

Parashikimet në projekt-buxhet u hartuan duke marrë në konsideratë një anëtarësi të pritshme prej 1000 anëtarësh, ndërkohë që deri në gusht 2017, numri i anëtarëve ishte vetëm 460, pra as ½ e anëtarësisë së parashikuar. Mospërmbushja e të ardhurave të pritshme krijoi jo pak vështirësi në funksionim.



Në shtator 2017, me nisjen e procesit të licencimeve të para, të ardhurat e parashikuara nisën të plotësoheshin, si pasojë e mbledhjes së të ardhurave nga tarifa e licencimit, të ardhura të cilat nuk ishin parashikuar në fillim të vitit, pasi procesi i licencimit nuk u parashikua se do të fillonte në një kohë kaq të shpejtë. Në vitin në vazhdim një prej prioriteteve më kryesore është rritja e numrit të anëtarësisë, që në kuadrin ekonomik do të rrisë të ardhurat, do të shtojë shërbimet dhe aktivitetet dhe do të ndihmojë në fuqizimin e rolit të psikologut.

Shpenzimet sipas kategorive për vitin 2017	
Shpenzime për pagat	2,331,102 ALL
Shpenzime operative	2,886,096 ALL
Shpenzime kapitale	760,500 ALL
Shpenzime të paparashikuara	600,798 ALL
Total	7,092,218 ALL

Në Buxhetin e vitit 2017 është synuar të plotësoheshin nevojat bazike për ngritjen dhe zhvillimin në normalitet të aktivitetit të Urdhrit. Shpenzimet janë kryer në përputhje me parashikimet buxhetore të programuara në varësi të të ardhurave.

Nga ky vit, si pasojë e diferencës mes të ardhurave dhe shpenzimeve, është krijuar një rezervë për vitin në vijim në vlerën rreth 1,850,000 ALL.

Shpërndarja e shpenzimeve sipas zërave



11. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2018

- Rritja e anëtarësimeve në Urdhrin e Psikologut, nëpërmjet ndërgjegjësimit, sensibilizimit dhe rritjes së bashkëpunimit me institucionet.
- Miratimi i akteve nënligjore për rregullimin e mënyrës së kryerjes së praktikës profesionale dhe të provimit të shtetit.
- Fuqizimi i rolit dhe statusit të psikologut në institucione, nëpërmjet miratimit të protokolleve të punës për secilën fushë të kompetencës.
- Njohja dhe zbatimi i Kodit të Etikës dhe Deontologjisë së Psikologut në çdo aspekt të ushtrimit të profesionit.
- Përcaktimi dhe ndërtimi i një kuadri normativ për rregullimin e sistemit të edukimit në vazhdim për psikologët
- Sensibilizimi mbi rolin e psikologut organizacional dhe ndërrmarrja e nismave për aplikimin në vend të psikologjisë organizacionale në institucione publike dhe private
- Përpilimi i akteve dhe bashkërendimi i punës me Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë për kalimin e psikologut të shkollave në statusin e specialistit dhe jo në atë të mësuesit, sikundër vijon të jetë që prej vitit 2004.
- Bashkëpunim të ngushtë me pushtetin qëndror dhe lokal, jo vetëm në fuqizimin e rolit të psikologut, por edhe në projekte të përbashkëta në nivel lokal dhe kombëtar, të cilat do i vijnë në ndihmë komunitetit dhe do të faktorizojnë punën e psikologut.
- Fillimi i punës për ngritjen e rrjetit të koordinatorëve lokal ose zyrave rajonale të Urdhrit.
- Bashkëpunim me të gjitha Ministritë e linjës, lidhur me ngritjen e strukturave psiko-sociale për implementimin e ndryshimeve ligjore në fushën e drejtësisë penale, të cilat parashikojnë përfshirjen e specialistit psikolog në proces.
- Rritja e bashkëpunimit në marrëdhëniet ndërkombëtare, duke synuar marrjen e statusit të vendit kandidat në Shoqatën Europiane të Psikologëve të Punës dhe Organizacionalë "*European Association of Work and Organizational Psychology* ("EAWOP")
- Marrja e statusit të vendit kandidat në *Federatën Europiane të Shoqatave të Psikologëve, (European Federation of Psychologists' Associations* "EFPA").